



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.868/14

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me procesëmbajtësen Nexhmije Abazxhik, në konfliktin administrativ, të paditësit Agjensioni Doganor U. Sh. nga P. kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: rivlerësim i mallit doganor, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 15.06.2016, në mungesë të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkespadija e paditësit Agjensioni Doganor U. Sh. nga P., si e bazuar.

ANULOHET aktvendimi nr.06.2.1/75,76/2007 datës 26.05.2014 i Doganës së Kosovës në Prishtinë

OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që, për shkak të shitjes së mallit doganor në ankand publik, i deklaruar në mënyrë të drejtë në procedurën e zhdoganimit me kodin tarifor 87.04 sipas Deklaratave Unike Doganore 1926/15.02.2007 dhe 1927/15.02.2007 D.D.Podujevë, paditësit Agjensioni Doganor U. Sh. nga P., t,ia paguaj shumën ekuivalente me shumën e deklaruar, prej 1,100€ (njëmij, e njëqin euro).

A R S Y E T I M

Me vendimin kontestues e paditura ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit nr.06.2.1/75,76 datës 27.02.2007, si të pabazuar.

Paditësi Agjensioni Doganor U. Sh. nga P. me padin e paraqitur në Gjykatë, me datë 11.06.2014, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të paditues Dogana e Kosoves në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata aprovimin e kërkespadijs si të bazuar, anulimin e vendimit të kundërshtuar dhe paditësit ti pranohet dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor me kodin tarifor 8704 dhe ti mundësohet pagesa e taksës doganore importuese, në të kundërtën të obligohet Dogana e Kosovës që paditësit t,ia paguaj kundërvlerën e mallit lëndor dhe ti paguhet kamata e grumbulluar që nga data e deklarimit të mallit lëndor për zhdoganim konform nenit 292 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

Në padin e tij paditësi deklaroi: me rastin e zhdoganimit të mallit për zhdogaim në zyren doganore Podujevë kemi prezantuar të gjithë dokumentacionin e duhur që kërkohet me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si librezat, faturat e eksportuesit, etj. Edhe përkundër vërejtjeve të dhëna në vendimin e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime në riprocedurë Dogana e Kosovës e refuzon kërkesën për rishqyrtimin e vendimit nr.06.2.1/75,76 dt.27.02.2007. Gjykata Supreme e Kosovës në konfliktin administrativ ka aprovuar padin dhe ka kthyer lëndën në riprocedurë. BPR ka nxjerr konstatimin se nuk është dhënë asnjë arsyetim i duhur përse malli kontestues nuk klasifikohet në pozicionin tarifor 87.04 dhe nuk është dhënë asnjë provë për të dëshmuar se paditësi ka zhdoganuar mallin në pozicionin tarifor të pasakt. Ndërsa Dogana e Kosovës në aktvendimin e kundërshtuar krejtësisht ka marrë një vendim të gabuar, në arsyetim të vendimit thuhet se malli

kontestues është shitur në ankand publik pasi që pala në procedurë ka qenë i njoftuar me shkresën nr.384/26.12.2007 me të cilën pala është njoftuar se automjeteve në fjalë ti caktohet një trajtim i lejuar në afat prej 8 ditësh. Lidhur me këtë e njoftojm gjykatën se me asnjë provë nuk jemi njoftuar me këtë shkresë dhe nëse ekziston propozojm që të provohet se kush e ka pranuar atë shkresë. Pra siq po shihet është shitur malli lëndor pronë e paditësit në mënyrë të kundërligjshme dhe si pasoj e kësaj shetje organi i paditur nuk mund të konstatoj gjendjen faktike . Në fund të arsytimit të aktvendimit të kundërshtuar kemi të bëjmë me një kontradikt të arsytimeve ku dikun thuhet se gjendja faktike është e pamundur të konstatohet pasi nuk ekziston malli kontestues ndërsa dikun thuhet se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është provë e pamjaftueshmë sepse gjendja faktike e mallit është ndryshe nga ajo e dokumentuar.

E paditura përmes përfaqësueses së autorizuar në përgjigje në padi datës 09.02.2016 deklaroi: e kontestojm në tërsi kërkespadin e paditësit si të pabazuar. Në parashtrës janë përshkruar të njëjtat konstatime sikur në arsytimin e vendimit kontestues dhe në fund i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkespadis së paditësit në tërsi si të pabazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 15.06.2016, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi dt. 09.02.2016 nga Ministria e Drejtësisë, aktvendimi nr.06.2.1./75,76/2007 dt.26.05.2014 nga Dogana e Kosovës, aktvendimi nr.30/2006 dt.14.04.2014 nga BPR, deklaratat unike doganore, deklaratat eksportuese, faktura e mallit, libreza e automjetit, foto-dokumentacioni, aktvendimi nr. 06.2.1 nr. 75,76 i dt. 27.02.2007 nga Shërbimi Doganor, raport mbi konstatimin e gjendjes faktike dt.15.02.2007, aktvendimi nr.15/21.01.2008 dt. 21.01.2008 i Shërbimit Doganor, shënim i brendshëm dt. 09.03.2009 nga Dogana e Kosovës, aktgjykimi A.nr.1424/2007 dt.14.04.2009 nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vërtetoi këtë gjendje faktike:

- Me aktvendimin 06.2.1nr.75,76 datës 27.02.2007 e paditura ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve nr.1926 dhe 1927/15.02.2007 në zyrën doganore Podujevë, me të cilat vendime i është kontestuar kodi i mallit lëndor.
- Në procedurën e ankesave tek organi administrativ i shkallës së dytë Bordin i Pavarur për Rishqyrtime me aktvendimin A.nr.30/2006 dt.02.06.2007 ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi vendimin e të paditues 06.2.1 nr.75,76 dt.27.02.2007.
- Në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin A.nr.1424/2007 dt.14.04.2009 ka aprovuar padin e paditësit dhe ka anuluar aktvendimin e BPR A.nr.30/2006 dt.02.06.2007.
- Organi administrativ i shkallës së dytë BPR me aktvendimin A.nr.30/2006 dt.14.04.2007 ka aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar, ka anuluar aktvendimin e të paditues dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.
- E paditura Dogana e Kosovës me aktvendimin 06.2.1/75,76/2007 dt.26.05.2014 në rivendosje ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit 06.2.1/75,76 dt.27.02.2007

Në seancën e mbajtur me datë 15.06.2016, pas shqyrtimit të pretendimeve të padisë, vlerësimit të provave materiale të prezantuara me padi si dhe përgjigjes në padi dhe shkresave të lëndës, gjykata konstatoi se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar për këto arsye:

Organi i paditur Dogana e Kosovës nuk i ka marr për bazë vërejtjet e dhëna nga aktgjykimin i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe vendimit të organit administrativ të shkallës së dytë BPR-së, se kontestimi i

klasifikimit tarifor të automjeteve nuk përmban arsyetimin ku do të dëshmohej me prova se pse ky mall nuk klasifikohet në kodin 87.04 por në 87.03, sepse nuk ka përshkrim detal të mallit, nuk është i bazuar në komentet dhe vërejtjet nga Komentarët e Tarifës Doganore, nuk është ofruar asnjë provë konkrete nga prodhuesi i mallit lëndor lidhur me dedikimin final që kishte me kontestuar dokumentacionin e prezantuar si automjet transportues, ose se gjatë përdorimit të tij i është ndryshuar dedikimi i përdorimit, dhe së paragykimet se i njëjti mund të shëndrrohet në automjet për udhëtar nuk mund të jetë bazë për ndryshimin e kodit tarifor. Në anën tjetër dokumentacioni që e ka përcjell mallin e përshkruan atë si automjet transportues provë: DUD i transitit, librezë e qarkullimit Itali ku ceket se kemi të bëjmë me automjete për transport.

Nga ekzaminimi i arsyetimit të vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës vendimin e vet kontestues me të cilin ka refuzuar kërkesën e paditësit dhe nuk ka marr për bazë vërejtjet e organit më lart administrativ dhe atij gjyqësor, e ka mbështetur në faktin se nuk mund të merret mendimi i Sektorit të Tarifës sepse malli kontestues nuk gjendet në Doganën e Kosovës dhe se malli kontestues është shitur në ankand publik pasi që paditësi nuk është përgjigjur në shkresën nr.384/26.12.2007 me të cilën është ftuar ti caktohet një trajtim i lejuar doganor, atëher SHDU ka ndërmar masat për shitjen e automjeteve. Gjithashtu thekson se konstatimi i gjendjes faktike në përshkrimin detal të mallit bazuar në komente dhe vërejtje nga komentaret e Tarifës doganore, në këtë fazë është e pamundur meqenëse nuk është malli kontestues dhe për konstatimin e drejt të gjendjes faktike të mallit është i domosdoshëm të plotsohet edhe kriteri i pranisë së mallit.

Nga të gjitha provat e administruara në procedurën e konfliktit administrativ, gjykata i pranon konstatimet e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe BPR-së, se në bazë të dokumentacionit përcjellës të mallit doganor, malli-automjetet janë të dedikuara për transport të mallrave, fakt ky që vërtetohet në librezat e qarkullimit të automjeteve nga shteti eksportues Itali nr. DA0896119 dhe DA0896302, ku ceket se kemi të bëjmë me automjete për transport, pastaj në deklaratën e tranzitit figuron kodi tarifor 8704 që sipas TARIK-ut nënkupton se malli lëndor hyn në klasifikimin tarifor të mallrave transportuese. Kjo gjykatë nuk i konsideron si të pranueshme vlersimet e dhëna nga zyra doganore kur konteston kodin tarifor të mallit lëndor të deklaruar me librezën përkatëse, vetëm në bazë të disa tipareve ekzistuese të automjeteve si: dizajnimi, dritaret në pjesën e pasme, prezenca e tipareve të komfortit dhe finesave të brendshme, pa u verifikuar me asnjë provë konkrete librezë nga prodhuesi i mallit lëndor për tu konfirmuar dedikimi i përdorimit final të automjeteve, apo për tu vërtetuar pretendimet se gjatë përdorimit të automjeteve iu është ndryshuar destinimi i përdorimit. Në rastin konkret gjykata konstaton se e paditura në rivendosje nuk ka mundur të vërtetojë drejt gjendjen faktike që është kërkuar nga organi më lart administrativ dhe atij gjyqësor që të bëhet klasifikimi i sakt tarifor i automjeteve sipas TARIK-ut nga Sektori profesional Tarifor që ekziston brenda Doganës së Kosovës, dhe e paditura nuk ka arritur të sigurojë asnjë provë të re nga shteti eksportues apo prodhuesi i mallit që do të dëshmonte një gjendje tjetër të destimit të automjeteve nga shënimet e deklaruara të dokumentacionit sipas Deklaratave Unike Doganore 1926/15.02.2007 dhe 1927/15.02.2007 D.D.Podujevë. Prandaj kjo gjykatë duke pasur parasysh se e paditura në rivendosje nuk ka mundur të vërtetojë dyshimet e vlefshmërisë së provave të prezentuara nga pala paditëse me rastin e zhdoganimit të mallit lëndor, librezave të qarkullimit të automjeteve dhe dokumentacionit tjetër përcjellës, nuk ka mundur të marr mendimin e Sektorit Tarifor për shkak se malli kontestues është shitur në ankand publik, atëher e paditura është dashur të pranohet dokumentacionin e deklaruar me kodin tarifor 8704, dhe malli të del në qarkullim të lirë pas pagesave të detyrimeve importuese. Si rezultat i mos konstatimit të kësaj gjendje faktike për shkak se nuk gjenden automjetet nën mbikqyrje doganore, gjykata konstaton se e paditura ka aplikuar gabimisht edhe të drejtën materiale kur referohet në Rregulloren e UNMIK-ut 2006/2 mbi ndalimin e importit të automjeteve më të vjetra se 8 vite të cilat klasifikohen nën kodin 8703.

Përkundër faktit se kjo çështje administrative doganore ka qenë duke u shqyrtuar në procedurën e ankesave tek organi më lart administrativ BPR-së dhe në Gjykatë, zyra doganore Podujevë në ndërkohë ka nxjerr vendimin nr.15/21.01.2008 me të cilin ka konfiskuar mallin lëndor, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin A.nr.1424/2007 dt.14.04.2009 i ka bërë me dije të paditës se me aktvendimin A.nr.1424/2007 dt.09.03.2009 është aprovuar kërkesa e paditësit për kthimin në gjendjen e mëparshme dhe çështja është kthyer në gjendjen në të cilën ka ekzistuar para nxjerrjes së aktvendimeve paraprake.

Nga këto fakte të lartcekura, gjykata konstaton se e paditura nuk ka vepruar drejt kur ka kontestuar kodin tarifor të mallit lëndor të deklaruar në kodin 8704 sipas DUD-ave të lartcekur, sepse nuk ka arritur të siguroj asnjë provë e re për të kundërshtuar dokumentacionin përcjellës të mallit lëndor, dhe nuk është bërë konstatimi i drejt i gjendjes faktike në kuptim të klasifikimit tarifor sipas TARIK-ut nga Sektori i Tarifës i Doganës së Kosovës.

Prandaj në bazë të gjendjes faktike që ka rezultuar nga shkresat e lëndës, gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara, të drejta e të ligjshme andaj në tërësi aprovon kërkespadin e paditësit dhe e anulon aktvendimin nr.06.2.1/75,76/2007 datës 26.05.2014 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, si i pabazuar në ligj.

Në rastin konkret duke pasur parasysh se malli lëndor që është objekt shqyrtimi në këtë konflikt administrativ gjyqësor, nuk gjendet në posedim të paditues e që sipas arsytimit të vendimit kontestues, i njëjti mall është shitur në ankand publik, gjykata duke marr parasysh këtë fakt, e detyron të paditues që konform nenit 292 pika (ii) (A) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, paditësit Agjensionit Doganor U. Sh. nga P., t,ia paguaj shumën ekuivalente me shumën e deklaruar, e që vlera e mallit lëndor sipas Deklaratave Unike Doganore Doganore 1926/15.02.2007 dhe 1927/15.02.2007 D.D.Podujevë, është gjithsejt 1,100€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal
A.nr.868/2014 datë 15.06.2016

Gjyqtari,
Krenar Berisha

KESHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, ne Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.